UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Kryesuese e Senatit
Prof.dr. Nurten Deva

Nr. Prot. 1863 Dt 30.07.2026

Senati i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, bazuar në Rregulloren nr. 1670, dt.28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini, në Mitrovicë, si dhe Rregulloren nr. 2205, dt.26.09.2025, për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë në mbledhjen e mbajtur më 29.07.2026, mori:

VENDIM

I. Anulohet pjesërisht konkursi për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë për vitin akademik 2026/2027, me nr.prot.1493 dt.17.06.2026, i korrigjuar me nr.prot.1500, dt.19.06.2026 .

II. Anulimi i konkursit të shpallur më dt.17.06.2026 dhe korrigjuar me 19.06.2026 bëhet për pozitat si në vijim:

Fakulteti i Gjeoshkencave

1. Një asistent për lëndet: Kimi, Kimia inorganike, Kimia e përgjithshme;
2. Një asistent për grup lëndësh në Gjeologji;

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

1. Një mësimdhënës për lëndët: "Gjuha gjermane I", "Gjuha gjermane II";
2. Një asistent për lëndët: "Gjuha gjermane I", "Gjuha gjermane II";
3. Një asistent për lëndët: "Bazat e informatikës", "Softueri aplikativ në inxhinierinë mjedisore";
4. Një asistent për lëndët: "Kimia e përgjithshme", "Kimia fizike", "Kimia fizike I", "Kimia fizike II", "Teknologjia e përpunimit të pemëve dhe perimeve", "Teknologjia e përpunimit të qumështit", "Metodologjia e punës kërkimore-shkencore";

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike

1. Një mësimdhënës për lëndët: "Sistemet e Bazës së të Dhënave", "Menaxhimi i Bazës së të Dhënave", "Programimi i Avancuar", "DevOps, Infrastruktura Cloud dhe Virtualizimi".
2. Një mësimdhënës për lëndët: "Menaxhimi i Projekteve në TI", "Përpunimi Big Data", "Bazat e Inteligjencës Artificiale", "Sistemet Kompjuterike Edge dhe të Integruara".
3. Një asistent për lëndët: "CAD/CAM", "Detalet e Makinave I", "CAE dhe Prodhimi Digjital", "Detalet e Makinave II", "Programimi i Makinave CNC", "Prodhimi i Zgjuar dhe Industria 5.0".
4. Një asistent për lëndët: "Mikroekonomi", "Analizë Financiare", "Parimet e Kontabilitetit", "Auditim", "Kontabiliteti i Kostos", "Ndërmarrësia", "Makroekonomi".

5. Një asistent për lëndët: "Menaxhimi i Operacioneve", "Biznis Ndërkombëtar", "Marketing", "Menaxhim i INVM", "Menaxhimi i Projekteve Inxhinierike", "Menaxhim Strategjik", "MZF".

Fakulteti Ekonomik

1. Një mësimdhënës për lëndët: "Financat Ndërkombëtare", "Parimet e Auditimit" dhe "Financa Publike".
2. Një Asistent për lëndët: "Menaxhimi i NVM-ve", "Menaxhimi i Projekteve Investive", "Menaxhimi i Inovacioneve dhe Kreativitetit", "Ndërmarrësia", "Menaxhimi i Resurseve Humane", "Qeverisja Korporative", "Menaxhmenti Strategjik", "Integrimi Ekonomik Europian" dhe "Vendimmarrja Menaxheriale".
3. Një Asistent për lëndët: "Parimet e Menaxhmentit", "Sjellje Organizative", "Menaxhimi i Operacioneve", "Ndërmarrësia Sociale", "Menaxhmenti Bankar" dhe "Lidershipi".
4. Një Asistent për lëndën: "E Drejta Biznesore".

Fakulteti Juridik

1. Një asistent për lëndët: "Fillet e së drejtës", "E drejta administrative", "E drejta kushtetuese", "Procedura Administrative", "E drejta e punës", "E drejta kushtetuese krahasuese", "Historia e shtetit dhe së drejtës".
2. Një asistent për lëndët: "E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut", "E drejta e BE-së", "E drejta ndërkombëtare publike", "Teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare", "Tema të zgjedhura nga e drejta e BE-së".
3. Një asistent për lëndët: "E drejta civile", "E drejta e detyrimeve", "E drejta ndërkombëtare private", "E drejta kontraktore", "E drejta private evropiane".

Fakultetit i Gjeoshkencave, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti Juridik;

1. Një asistent për lëndët Gjuhë angleze I dhe II.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Anulimi i konkursit për pozitat nga pika II bëhet për arsye se:

Në **Fakultetin e Gjeoshkencave**, për pozitën: "Një asistent për lëndet: Kimi, Kimia inorganike, Kimia e përgjithshme" për shkak të gabimeve përmbajtësore në evidentimin e kandidatëve aplikues në raportin e komisionit vlerësues.

Ndërsa për pozitën: "Një asistent për grup lëndësh në Gjeologji" për shkak të mos precizimit të saktë të lëndëve për të cilat është shpallur konkursi dhe gabimeve përmbajtësore në raportin e komisionit vlerësues.

Në **Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore**, për pozitat: "Një mësimdhënës për lëndët: Gjuha gjermane I dhe Gjuha gjermane II" dhe "Një asistent për lëndët: Gjuha gjermane I dhe Gjuha gjermane II", për arsye se nuk ka pasur aplikantë të interesuar.

Për pozitën: "Një asistent për lëndët: "Bazat e informatikës", "Softueri aplikativ në inxhinierinë mjedisore" për shkak të shkeljeve procedurale në dokumentet e pranuara nga komisioni vlerësues duke mos respektuar kriteret e konkursit.

Për pozitën: "Një asistent për lëndët: "Kimia e përgjithshme", "Kimia fizike", "Kimia fizike I", "Kimia fizike II", "Teknologjia e përpunimit të pemëve dhe perimeve", "Teknologjia e përpunimit të qumështit", "Metodologjia e punës kërkimore-shkencore" për shkak të mos precizimit/ndarjes të saktë lëndëve sipas programit për të cilat është shpallur konkursi dhe gabimeve përmbajtësore në raportin e komisionit vlerësues.

Në **Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike** për pozitën: "Një mësimdhënës për lëndët: "Sistemet e Bazës së të Dhënave", "Menaxhimi i Bazës së të Dhënave", "Programimi i Avancuar", "DevOps, Infrastruktura Cloud dhe Virtualizimi" për shkak se kandidati që ka aplikuar nuk ka pasur dosjen e kompletuar sipas kritereve të konkursit.

Për pozitën: "Një mësimdhënës për lëndët: "Menaxhimi i Projekteve në TI", "Përpunimi Big Data", "Bazat e Inteligjencës Artificiale", "Sistemet Kompjuterike Edge dhe të Integruara" për shkak se nuk ka aplikuar asnjë kandidat.

Për pozitën: "Një asistent për lëndët: "CAD/CAM", "Detalet e Makinave I", "CAE dhe Prodhimi Digjital", "Detalet e Makinave II", "Programimi i Makinave CNC", "Prodhimi i Zgjuar dhe Industria 5.0" për shkak se nuk ka aplikuar asnjë kandidat.

Për pozitën: "Një asistent për lëndët: "Mikroekonomi", "Analizë Financiare", "Parimet e Kontabilitetit", "Auditim", "Kontabiliteti i Kostos", "Ndërmarrësia", "Makroekonomi" për shkak të mos respektimit të nenit 6 pika 4 të Rregullores nr. 1670, dt.28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini, në Mitrovicë lidhur me përbërjen e komisionit vlerësues.

Për pozitën: "Një asistent për lëndët: "Menaxhimi i Operacioneve", "Biznis Ndërkombëtar", "Marketing", "Menaxhim i INVM", "Menaxhimi i Projekteve Inxhinierike", "Menaxhimi Strategjik", "MZF" për shkak të mos respektimit të nenit 6 pika 4 të Rregullores nr. 1670, dt.28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini, në Mitrovicë lidhur me përbërjen e komisionit vlerësues.

Në **Fakultetin Ekonomik** për pozitën: "Një mësimdhënës për lëndët: "Financat Ndërkombëtare", "Parimet e Auditimit" dhe "Financa Publike" - për shkak të mos respektimit të nenit 6 pika 5 të Rregullores nr. 1670, dt.28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini, në Mitrovicë lidhur me përbërjen e komisionit vlerësues.

Për pozitën: "Një Asistent për lëndët: "Menaxhimi i NVM-ve", "Menaxhimi i Projekteve Investive", "Menaxhimi i Inovacioneve dhe Kreativitetit", "Ndërmarrësia", "Menaxhimi i Resurseve Humane", "Qeverisja Korporative", "Menaxhmenti Strategjik", "Integrimi Ekonomik Europian" dhe "Vendimmarrja Menaxheriale" - për shkak të mos respektimit të nenit 6 pika 5 të Rregullores nr. 1670, dt.28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini, në Mitrovicë lidhur me përbërjen e komisionit vlerësues.

Për pozitën: "Një Asistent për lëndët: "Parimet e Menaxhmentit", "Sjellje Organizative", "Menaxhimi i Operacioneve", "Ndërmarrësia Sociale", "Menaxhmenti Bankar" dhe "Lidershipi" - për shkak të mos respektimit të nenit 6 pika 5 të Rregullores nr. 1670, dt.28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini, në Mitrovicë lidhur me përbërjen e komisionit vlerësues.

Për pozitën: Një Asistent për lëndën: "E Drejta Biznesore" – për shkak se nuk ka aplikuar asnjë kandidat.

Në **Fakultetin Juridik** për pozitën: "Një asistent për lëndët: "Fillet e së drejtës", "E drejta administrative", "E drejta kushtetuese", "Procedura Administrative", "E drejta e punës", "E drejta kushtetuese krahasuese", "Historia e shtetit dhe së drejtës" - për shkak të mos respektimit të nenit 6 pika 5 të Rregullores nr. 1670, dt.28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini, në Mitrovicë lidhur me përbërjen e komisionit vlerësues.

Për pozitën: "Një asistent për lëndët: "E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut", "E drejta e BE-së", "E drejta ndërkombëtare publike", "Teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare", "Tema të zgjedhura nga e drejta e BE-së" – për shkak se nuk ka aplikuar asnjë kandidat.

Për pozitën: "Një asistent për lëndët: "E drejta civile", "E drejta e detyrimeve", "E drejta ndërkombëtare private", "E drejta kontraktore", "E drejta private evropiane" - për shkak të mos respektimit të nenit 6 pika 5 të Rregullores nr. 1670, dt.28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini, në Mitrovicë lidhur me përbërjen e komisionit vlerësues.

Bazuar në këto që u cekën, Senati mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kandidatët e pakënaqur mund të kontestojnë këtë vendim në Gjykatën kompetente, në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrës për informim me publikun;
4. Zyrës për çështje akademike;
5. Zyrës ligjore;

UNIVERSITETI »ISA BOLETINI« MITROVICË

Prof.dr.Nurten Deva

Kryesuese e Senatit